

## URBANISM WATCH

Urbanizmi i Prizrenit nën  
vëzhgim të përhershëm

4 shkurt 2014, Prizren

Komunikatë #10

### KOMUNIKATË PËR MEDIA

## URA E GURIT DHE E ARASTËS, DËSHMI TË MUNGESËS SË SHTETIT LIGJOR

“EC Ma Ndryshe” në kuadër të projektit “Urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm” ka shqyrtuar sërish çështjen e ndriçimit të Urës së Gurit dhe atë të Arastës, në Qendrën Historike të Prizrenit.

Gjatë muajit janar monitoruesit e organizatës kanë kërkuar sqarime nga Drejtoria për Shërbime Publike në lidhje me afatin e largimit të ndriçimit nga këto ura, që vitin e kaluar ishin vendosur pa leje të Drejtorisë së Urbanizimit dhe Planifikimit Hapësinor dhe pa pëlqimet e Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve Historike dhe të Këshillit për Trashëgimi Kulturor të Qendrës Historike të Prizrenit. DSHP nuk e ka parë të udhës që të ofroj përgjigje, duke shkelur parimet bazë të transparencës, por edhe dispozitat e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

Në muajin nëntor të vitit të kaluar DSHP pat sqaruar se me 11 shtator 2013 ka lëshuar pëlqimin për NSH “Hisar Kosova” për pastrimin e shtratit të Lumëbardhit, rregullimin e mureve mbrojtëse në vendet e dëmtuara dhe ndriçimin e urave në qytet. “Përkohësisht është bërë ndriçimi i urave i cili do qëndrojë deri në festat e fundvitit dhe janë bërë disa riparime të vogla si ngjyrosja e parmakëve, rregullimi i trotuarit në urë, të cilat kanë qenë mjaft të dëmtuar dhe mundë të qëndrojnë deri në rregullimin e urës së re”, thuhej në përgjigjen e DSHP-së.

Edhe pse kanë kaluar më shumë se një muaj nga përfundimi i festave të fundvitit ndriçimi ilegal në urat e lartpërmendura vazhdon të funksionoj. EC Ma Ndryshe 3 muaj më parë pat dokumentuar intervenimet pa leje e pa pëlqime në këto ura, që përbëjnë shkelje të drejtpërdrejta të dispozitave të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit (Linku ku mund të gjeni komunikatën e mëparshme: [http://www.online-transparency.org/repository/docs/UW\\_Komunikate\\_6.pdf](http://www.online-transparency.org/repository/docs/UW_Komunikate_6.pdf)).

EC Ma Ndryshe përkujton sërish se ky ligj, përcakton se për çdo aktivitet në Qendrën Historike duhet të konsultohen Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Prizrenit dhe Këshilli për Trashëgimi Kulturor i Qendrës Historike dhe se pas pëlqimeve të tyre Drejtoria e Urbanizimit lëshon lejen përkatëse ose e refuzon duke u bazuar në Planin e konservimit dhe ligjet në fuqi.

Rasti i këtyre dy urave tregon mungesën e vullnetit të institucioneve komunale për të përfillur ligjet në Qendrën Historike të Prizrenit.

Marrë parasysh neglizhencën e Komunës së Prizrenit, EC Ma Ndryshe i bën thirrje MMPH-së dhe MKRS-së që të intervenojnë për zbatimin e ligjshmërisë në Qendrën Historike të Prizrenit, duke nisur nga Ura e Gurit dhe ajo e Arastës.

EC Ma Ndryshe gjithashtu inkurajon institucionet mbikëqyrëse, si IMMH-në dhe KTK-në në veçanti, për denoncimin publik të këtyre rasteve.

“EC Ma Ndryshe” në korrik të vitit 2013 ka nisur zbatimin e projektit “Urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm”, përkrahur financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Nevoja për mbikëqyrjen e zhvillimeve në sektorin e urbanizimit ka rrjedhë si pasojë e zhvillimeve të shumta negative gjatë periudhës së pasluftës dhe tranzicionit që janë manifestuar me degradimin urban dhe planifikimin e pabalancuar hapësinor. Projekti do të vazhdoj me monitorimin dhe publikimin e të gjeturave në sektorin e urbanizimit dhe planifikimit hapësinor, sikurse edhe me adresimin e përgjegjësisë institucionale.

Me nderime,  
Valon Xhabali, Koordinator i Projektit  
OJQ EC Ma Ndryshe  
Rr. Saraçët, Nr. 5 – Prizren &  
Perandori Dioklecian 14, Kati V, 10000 Prishtinë  
[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) & [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)  
+381 38 224 967 & +381 29 222 771

## URBANISM WATCH

Urbanizmi i Prizrenit nën  
vëzhgim të përhershëm

përkrahët financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur

# SOROS

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur  
Kosovo Foundation for Open Society  
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo